

KËRKESË
Nr. 10106, datë 19.7.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “P4_C2_d Kopshti i sekreteve, kënd lojërash (*Garden of secrets*) në lagjen “Uji i Ftohtë”, Vlorë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000, si dhe të udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të EKB-së Tiranë, për llogaritjen e vlerës së truallit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 41 085 717 (dyzet e një milion e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA E PRONAREVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI
“P4_C2_d KOPSHTI I SEKRETEVE, KËND LOJËRASH (*GARDEN OF SEKRETS*) NE LAGJEN “UJI I FTOHTE”, VLORË”

Çmimi i truallit sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.

Çmimi për objektet sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të EKB-së Tiranë.

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Lloji i Pronës	Sipërfaqe trualli m²	Çmimi i truallit, lekë/m²	Vlera e truallit, lekë	Sipërfaqe ndërtimi m²	Vlera e ndërtimit, lekë	Vlera truall dhe ndërtesë (lekë)	Shënime
1	8602	36/256	Vlorë	Adivije Lamaj, Drita Gabvrani, Fasli Hajro, Mjaflore Beqiraj, Mylyse Voshtina, Memli Xhaferi, Sadedin Xhaferi, Bernoreta Xhaferi dhe Faire Lloja	Truall	3562	10903	38,836,486	0.00		38,836,486	Ne seksionin D ka shënimin: me nr. dok. 021014, datë 20.4.2017 tipi k. hip: Registrohet aktmarrëveshja nr. 250 kol., datë 20. 4.2017, dhe kontrata e hipotekimit nr. 332 rep, nr. 251 kol., datë 20.4.2017, nëpërmjet shoqërisë “Lazaj” sh.p.k. dhe Fasli Hajro, për 1/2 pjesë. Te kapitulli “Përshkrimi i veçantë” është vënë shënim: Parcela prej 800 m² është hapur te 36/ 257, pasi ndahet nga rruga. Te kjo pasuri bën pjesë edhe pasuria 36/249; 36/257, të cilat janë kufizuar për shkak të mbivendosjes. Këtu bëjnë pjesë edhe pasuritë 36/258, 36/259, të cilat janë hapur rrugë. Të zgjidhet problemi. Saktësim dokumentacioni.
2	8602	36/89	Vlorë	Fatbardha, Ferit, Mustafa, Nafize, Neire dhe Rezara Vokopola	Truall	145	10903	1,580,935	0.00		1,580,935	Në seksionin E ka shënimin: Ka 2 (dy) ndërtesa pa leje.
3	8602	36/99	Vlorë	Myqerem Hamzaraj	Pemëtore	136	204	27,744	0.00		27,744	Në seksionin E ka shënimin: Kufizim veprimesh deri në saktësimin e skicës.
4	8602	36/194	Vlorë	Shahin Bejdaj	Truall	6.5	10903	70,870	0.00		70,870	Në seksionin E ka shënimin: Rivlerësim pasurie 5,451,500.00 lekë. Vlen për 1 (një) transaksion. Në seksionin E ka shënimin: Diferencë dok. fakt. = 11.6 m².
5	8602	36/255	Vlorë	Fatbardha, Ferit, Mustafa, Nafize, Neire dhe Rezare Vokopola	Truall	52.25	10903	569,682	0.00		569,682	
VLERA TOTALE: 41,085,717												